



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Udhëzues
“Mbi Konfidencialitetin dhe Aksesin në Dosje”¹

I. Të përgjithshme.

1. Udhëzimi trajton çështjet kryesore në lidhje me konfidencialitetin dhe aksesin në dosje, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të BE-së, duke sqaruar konceptet dhe procedurat që lidhen me këto çështje.
2. Qëllimi i udhëzimit është të sqarojë konceptet dhe procedurat që ndiqen lidhur me aksesin në dosje dhe konfidencialitetin, duke ndihmuar si palët nën hetim por edhe palët e treta të interesuara lidhur me këto koncepte, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (këtu e në vijim Ligji 9121/2003); të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (këtu e në vijim Ligji për të Drejtën e Informimit); të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” (këtu e në vijim Kodi i Procedurave Administrative) dhe të Rregullores "Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës" (këtu e në vijim Rregullorja për Funkcionimin); të Rregullores "Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës" (këtu e në vijim Rregullorja për procedurat hetimore); të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” (këtu e në vijim Rregullorja për procedurat e përqendrimit); dhe të Udhëzimit “Për dëmet e shkaktuara dhe veprimet e ndërmarrja për shkelje të dispozitave të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (këtu e në vijim Udhëzimi për dëmet) si dhe të Programit për lehtësimin nga gjobot.

II. Konfidencialiteti dhe aksesin në dosje.

II.1 Kush ka të drejtën për të aksesuar dosjen

3. Legjislacioni shqiptar mbi të drejtën e informimit, i njeh të drejtën qytetarëve për të pasur akses në informacionin publik², si për shembull çdo të dhëne, të regjistruar në çfarëdo lloj forme apo formati, gjatë kryerjes së funksionit publik. Çdo qytetar mund të kontaktojë administratën publike dhe të kërkojë akses/qasje

¹ Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1/2003 / Council Regulation (EC) No 1/2003 of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty ; Commission Notice on the rules for access to the Commission file in cases pursuant to Articles 81 and 82 of the EC Treaty, Articles 53, 54 and 57 of the EEA Agreement and Council Regulation (EC) No 139/2004

² Neni 3 i Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

në informacionin publik, duke marrë dokumentin original ose një kopje të tij, pa pasur nevojë të shpjegojë arsyet që justifikojnë kërkesën.

4. Ligji për të drejtën e informimit përcakton disa kufizime në të drejtën për të pasur akses kur, ndër të tjera, zbulimi/dhënia e informacionit mund të dëmtojë tregtinë ose sekretet e biznesit³. Për më tepër, e drejta për të aksesuar informacionin, ndër të tjera, mund të kufizohet edhe në rastet kur dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe serioz, në "parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale"⁴.
5. Shtrirja e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës (këtu e në vijim AK) i nënshtrohet kufizimeve, të parashikuara nga nenet 28 dhe 29 të Ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", siç janë monitorimi dhe analizimi i kushteve të tregut, kryerja e hetimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve. Për këtë arsye, e drejta e përgjithshme për të aksesuar informacionin /mund të kufizohet në raste specifike gjatë procedurave të veprimtarisë së AK.
6. Në fakt, kufizime të caktuara për të drejtën për të aksesuar dokumente të dosjes janë përfshirë në Ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe në disa rregullore të AK-së (konkretisht, Rregullorja Për funksionimin, Rregullorja Për Procedurat Hetimore dhe Rregullorja Për procedurat e Përqendrimit).

II.1.1 Akses në dosjen e procedurave hetimore

7. Bazuar në rregulloret e sipër përmendura, ndërmarrjet nuk kanë të drejtë të konsultohen me dosjen, as në fazën e procedurës paraprake të hetimit⁵, as gjatë hetimit në sektorët e ekonomisë⁶. Pra, të gjitha hetimet e kryera gjatë të dy procedurave fillestare janë plotësisht konfidenciale.
8. Sidoqoftë, Rregullorja për Procedurat Hetimore, vlerëson që, pas fillimit të një hetimi të thelluar, konsultimi me dosjen e hetimit mund të ndodhë vetëm pasi të jetë dorëzuar raporti përkatës tek palët përkatëse⁷.
9. Për më tepër, nëse AK vendos në lidhje me një ankese duke e hedhur poshtë ankimin e bërë, ankuesi ka të drejtë të shqyrtojë dokumentat, për s akohë ato nuk përmbajnë përmbajnë sekrete biznesi dhe informacione të tjera konfidenciale, mbi të cilat Autoriteti mbështet vlerësimet e veta⁸.
10. Për sa i përket asaj se kush mund të ketë akses në dosje pas fillimit të hetimit të thelluar, Rregullorja për Procedurat e Hetimit përcakton që hetimi mund të përfshijë gjithë ndërmarrjet e përfshira, si dhe personin që ka një interes të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në hetim dhe që ka depozituar të dhëna dhe /ose ka bërë ankese në lidhje me fillimin e këtij hetimi⁹.
11. Sa i përket palëve të treta, si në Rregulloren e AK-së Për Procedurat Hetimore, ashtu edhe në Kodin e Procedurave Administrative, parashikohet se në një

³ Neni 17.1 i Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e Informimit"

⁴ Neni 17.2 i Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e Informimit"

⁵ Neni 4 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

⁶ Neni 4 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

⁷ Neni 5.8 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

⁸ Neni 16 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

⁹ Neni 6.1 dhe 5.4 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

procedurë hetimore, mund t'ë përshihen edhe persona të cilët përfaqësojnë interesa publike apo private, interesat e të cilëve mund të preken¹⁰.

12. Nëse një palë e tretë dëshiron të njihet/përshihet në procesin hetimor, duhet ti drejtohet AK me një kërkesë të arsyetuar, brenda 30 ditë nga data e publikimit të Vendimit për fillimin e një hetimi¹¹.
13. Prandaj, në procedurat hetimore, vetëm (i) palët nën hetim; (ii) një person me interes të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm i cili i ka siguruar/depozituar AK-së informacione ose ka bërë ankesë; dhe (iii) palët e treta që janë njohur nga AK, mund të kenë akses në dosje dhe kjo vetëm pasi Raporti i Hetimit ju është bërë me dije/ju është njoftuar.
14. Në çdo rast, aksesin në dosje nuk është automatik, por duhet drejtuar fillimisht një kërkesë AK. Rregullorja e AK përcakton që e drejta e aksesit duhet të ushtrohet nëpërmjet bërjes së një kërkesë të arsyetuar me shkrim, dhe Sekretariatit i shqyrton ato rast pas rasti, brenda një periudhë 30 ditore, duke njoftuar Komisionin¹².

II.1.2 Aksesin në dosje në procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

15. Për sa i përket procedurave të kontrollit të përqendrimeve, në zbatim të nenit 13.4 të Rregullores së Procedurave të Përqendrimit, aksesin në dosje do të lejohet atëherë kur AK ka paraqitur/depozituar gjetjet e saj palëve njoftuese, me qëllim që tu ofrohet këtyre të fundit mundësia për të ushtruar të drejtën e tyre të mbrojtjes. Për më tepër, dhe kundrejt kërkesës, AK mund të lejojë palët e tjera të interesuara, të cilët janë informuar në lidhje me gjetjet, për të konsultuar dosjen brenda afatit të përcaktuar.
16. Në këtë drejtim dhe në përputhje me nenin 11 të Rregullores së Procedurave të Përqendrimit, ndërmarrjet e mëposhtme dhe/ose personat kanë të drejtë të dëgjohen dhe kështu mund të kërkojnë akses në dosje: (i) palët njoftuese; (ii) palët e tjera të përfshira, d.m.th. palët e tjera të përfshira në përqendrimin, me përjashtim të palëve njoftuese si shitësi dhe ndërmarrjes që është objekt përqendrimi; (iii) palët e treta të interesuara duke përfshirë konsumatorët, furnitorët, konkurrentët, dhe veçanërisht përfaqësuesit e administratës publike ose përfaqësuesit e shoqatës së këtyre ndërmarrjeve dhe; (iv) palët ndaj të cilave Komisioni i Konkurrencës po mendon të marrë një vendim bazuar në nenin 73,74 dhe 76 të ligjit 9121.

II.1.3 Aksesin në dosje pas përfundimit të procedurave.

17. Për të siguruar veprime efektive /nisma private në bazë të ligjit civil dhe zbatimin e ligjit të AK, një person që pretendon kompensim për dëme të pësuar si rezultat shkeljes së ligjit të konkurrencës, ka të drejtën të aksesojë informacionin përkatës që përmban dosja e AK-së. Sidoqoftë, kjo duhet të vlerësohet me kujdes, nëse

¹⁰ Neni 6.2 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

¹¹ Neni 6.1 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

¹² Neni 17.9 i Rregullores "Për Procedurat Hetimore në AK"

ekziston rreziku i zbulimit të dokumenteve që mund të ndikojnë negativisht në mënyrën në të cilën ndërmarrjet bashkëpunojnë me AK.

18. Bazuar mbi këto parime si dhe Udhëzimit mbi dëmet, një paraqitës i kërkesës për dëme, duhet të ketë akses në dokumentet e përcaktuara nga gjykata. AK do të paraqesë/depozitohet dokumentet në gjykatë.
19. Në asnjë rast, nuk do të zbulohet aplikimi i kryer për të përfituar nga Programi i Lehtësimi nga Gjohat. Vetëm informacionet e përgatitura për procedurat e AK-së, si dhe informacioni i përgatitur dhe dërguar palëve nga AK do të zbulohen, duke ndjekur kriteret e proporcionalitetit, dhe vetëm pasi AK të ketë mbyllur procedurat hetimore të saj.

II.2 Dokumentacioni për të cilin është i lejuar akses

20. Në zbatim të nenit 17 të Rregullores së Procedurave Hetimore, palët e përfshira në një procedurë sipas neneve 4, 5 dhe 9 të Ligjit 9121/2003 mund të aksesojnë dokumentet e përfshira në dosjen e hetimit. Sidoqoftë, akses/qasja në dokumente që përmbajnë sekrete biznesi, mund të rishikohet deri në pikën që i mundëson palëve të përfshira drejtpërdrejt në procedurë, të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes. Cdo palë e përfshirë në procedurën e hetimit, mund të mbrojë informacionin konfidencial të dhënë në kontekstin e hetimit, duke paraqitur një kërkesë të veçantë pranë Sekretariatit, duke sjellë argumente për të justifikuar natyrën konfidenciale të informacionit.
21. Duke ndjekur parimet e përgjithshme të transparencës dhe të drejtave të mbrojtjes, AK do të përjashtojë nga bërja publike dokumentet e brendshme të punës të hartuara nga AK gjatë punës për përgatitjen e dokumenteve zyrtare në lidhje me çështjen dhe sekretet e biznesit të ndërmarrjeve të tjera, ose informacione të tjera konfidenciale.
22. Po kështu, edhe në lidhje me procedurat e kontrollit të përqëndrimeve, lejohet akses në dokumentet e nevojshme për vlerësimin/analizimin e çështjes. Në çdo rast, informacioni i dhënë nuk do të shpërndahet jashtë Autoritetit nëse ai përmban sekrete biznesi ose informacione të tjera konfidenciale të ndonjë personi ose ndërmarrjeje, përfshirë palët njoftuese, palët e tjera të interesuara ose palët e treta, ose ndonjë informacion tjetër konfidencial i cili nuk është i nevojshëm për të vazhduar çështjen¹³.
23. Parimet dhe konceptet e trajtuara në seksionin më poshtë do të zbatohen në vlerësimin e pretendimeve për konfidencialitetin, në kontekstin e dosjeve të hetimit, kontrollin e përqëndrimeve si dhe vendimeve përfundimtare.

II.2.1 Dokumentet e aksesueshme

24. Në terma të përgjithshëm, palët duhet të jenë në gjendje të njihen me informacionin në dosjen e AK-së, në mënyrë që, mbi bazën e këtij informacioni, ata të mund të shprehin në mënyrë efektive pretendimet/pikëpamjet e tyre mbi

¹³ Neni 17 i Rregullores “Për zbatimin e procedurave të kontrollit të përqëndrimeve”

konkluzionet paraprake të arritura nga AK-ja në Raportin e saj të Hetimit. Për këtë qëllim, atyre do t'u jepet akses në të gjitha dokumentet e dosjes, me përjashtim të dokumenteve të brendshme përgatitore, sekretet e biznesit të ndërmarrjeve të tjera ose informacione të tjera konfidenciale. Ndërkohë, kuptohet ka një qasje të veçantë lidhur me programet e Lehtësimit nga Gjobat..

25. Palëve dhe personave ose ndërmarrjeve me një interes të drejtpërdrejtë do t'u lejohet gjithashtu qasje/akses në raportet e ekspertëve, analiza statistikore dhe ekonomike së bashku me të dhënat përkatëse që AK mund të kërkojë në kuadër të hetimit¹⁴.
26. Siç u përmend më lart, në procedurat e kontrollit të përqëndrimeve, aksesit do t'u jepet për dokumentet e nevojshme për analizimin e çështjes, me qëllim që të garantohet mundësia e mbrojtjes për palët dhe palët e tjera të interesuara¹⁵.

II.2.2 Dokumentat e paaksesueshme

A. Dokumentat e brendshme

27. Neni 17.4 i Rregullores së Procedurave Hetimore, parashikon që shënimet, propozimet dhe dokumentet e tjera të hartuara nga AK si pjesë e përgatitjes së dokumenteve zyrtare nuk do të jenë të aksesueshme/publike.
28. Këto dokumente të brendshme nuk do të përbejnë as bazë për inkriminim as bazë shfajësuese dhe ato nuk do të konsiderohen si një pjesë e provave në të cilat Komisioni mund të mbështetet në vlerësimin e tij të një çështjeje. Për shkak të mungesës së vlerës së tyre evidentuese, kufizimi në aksesimin e këtyre dokumenteve të brendshme nuk paragjykon të drejtën e palëve për tu mbrojtur.
29. Korrespondenca midis AK-së dhe institucioneve të tjera publike dhe autoriteteve të konkurrencës së shteteve të tjera ose organizatave ndërkombëtare mund të konsiderohet gjithashtu si dokument i brendshëm, dhe për këtë arsye, jo i aksesueshëm, nëse entiteti që ka prodhuar dokumentin nuk e autorizon përdorimin e tij nga palë të treta¹⁶.
30. Sidoqoftë, aksesit mund t'u jepet për këto dokumenta, pas fshirjes së sekreteve të biznesit ose informacioneve të tjera konfidenciale dhe marrjes së lejes nga institucioni përkatës. Bërja publike e këtyre komunikimeve mund të jetë me rëndësi, sepse ato përmbajnë pretendime të ngritura kundër palëve, ose prova të nevojshme në procesin hetimor, të cilat AK do t'i shqyrtojë.

B. Informacioni konfidencial

31. Nëse pas kryerjes së procedurave hetimore, konkludohet më herëtimin e një Raporti përkatës hetimor, AK do t'i lejojë akses në dosjes, e cila mund të përfshijë dokumente që AK i ka mbledhur në inspektime, dokumente të depozituara/paraqitura nga palët nën hetim ose nga palë të treta. Këto dokumente

¹⁴ Neni 12 i Rregullores “Për Procedurat hetimore në AK”

¹⁵ Neni 13.4 i Rregullores “Për zbatimin e procedurave të kontrollit të përqëndrimeve”

¹⁶ Neni 17.5 i Rregullores “Per procedurat Hetimore në AK”

mund të përmbajnë informacion konfidencial, zbulimi i të cilit mund të dëmtojë rëndë interesin e një pale. Kjo është arsyeja pse konfidencialiteti, është një kufizim i justifikuar dhe i pranuar në të drejtën për të pasur akses të pakufizuar në dosje.

32. Në mënyrë që informacioni të konsiderohet konfidencial, është e nevojshme të përmbushen kushtet e mëposhtme kur: (i) informacioni duhet të jetë në disponimin e një numëri të kufizuar personash; (ii) bërja publike e tij shkakton dëme serioze ndaj personit që e ka siguruar atë ose tek palë të treta; (iii) interesat që mund të dëmtohen nga bërja publike e tij duhet të jenë objektivisht të denja për mbrojtje.

33. Dosja e AK mund të përfshijë dokumente që përmbajnë dy kategori informacioni: sekretet e biznesit dhe informacione të tjera konfidenciale, për të cilat aksesimi mund të jetë i kufizuar pjesërisht ose plotësisht. Aksesimi do të jepet, kur është e mundur, për versionet jo konfidenciale të informacionit origjinal. Në rastet kur konfidencialiteti mund të sigurohet vetëm duke bërë një përmbledhje të informacionit përkatës, atëherë aksesimi mund të jepet për përmbledhjen. Të gjitha dokumentet e tjera duhet të jenë të aksesueshme në formën e tyre origjinale.

34. Sekretet e biznesit përfshijnë çdo informacion në lidhje me veprimtarinë e biznesit të një ndërmarrjeje, zbulimi i të cilit mund të rezultojë në një dëm serioz për të njëjtën ndërmarrje. Shembuj të informacionit që mund të kualifikohen si sekrete biznesi përfshijnë: informacion teknik dhe / ose financiar në lidhje me kapacitetet zhvilluese të ndërmarrjes (knoë-hoë), metodat e vlerësimit të kostove, sekretet e prodhimit dhe të përpunimit, burimet e furnizimit, sasitë e prodhuara dhe të shitura, pjesët e tregut, listat e klientëve dhe distributorëve, planet e marketingut, strukturat e kostos dhe çmimit dhe strategjinë e shitjeve¹⁷. Të dhënat e mëposhtme normalisht trajtohen si sekrete biznesi:

- Informacion teknik dhe / ose financiar në lidhje me njohuritë teknike të një ndërmarrjeje;
- Metodat e vlerësimit të kostos;
- Procesi i prodhimit, metodat dhe / ose asetet/aktivitet;
- Sasitë e prodhuara dhe të shitura;
- Vlerësimet për pjesët e tregut që nuk bazohen në të dhëna publike ose lehtësisht të aksesueshme;
- Dosjet / listat ose të dhënat specifike të konsumatorëve, shpërndarësve dhe furnizuesve;
- Strategjia tregtare dhe e shitjes;
- Strukturën / listat ose të dhënat specifike të kostos dhe çmimeve;
- Xhiro që nuk përfshihet në llogaritë e kompanisë.

35. Të dhëna të tjera konfidenciale përfshijnë informacione që do ju mundësonin palëve të identifikojnë ankuesit ose palët e tjera të treta, kur ata dëshirojnë të mbeten anonimë, pasi zbulimi i tij do t'i dëmtonte ndjeshëm ata.

¹⁷ Notice on the rules for access to the Commission file in cases pursuant to Articles 81 and 82 of the EC Treaty, Articles 53, 54 and 57 of the EEA Agreement and Council Regulation (EC) No 139/2004.

36. Vlerësimi i asaj çka përbën një "sekret biznesi" ose "informacion tjetër konfidencial" do të bëhet nga AK-ja, rast pas rasti. Megjithatë, informacioni i mëposhtëm normalisht nuk konsiderohet konfidencial.

-Informacioni në lidhje me një ndërmarrje i cili është i disponueshëm ose i njohur për publikun jashtë ndërmarrjes (ose grupit të cilit ndërmarrja i përket) ose jashtë shoqatës së cilës i është komunikuar. Cdo lloj informacioni, duke përfshirë atë në lidhje me çmimet, klientët, objektivat, etj., i cili është në dispozicion të specialistëve të sektorit ose është pjesë e informacionit publik, humbet natyrën e tij konfidenciale.

37. Informacioni që ka humbur rëndësinë e tij tregtare me kalimin e kohës. Normalisht, informacioni i lidhur me një periudhë 5 vjeçare ose më shumë do të humbasë kualifikimin e tij si sekret biznesi. Në këto raste, AK mund ta konsiderojë informacionin konfidencial vetëm nëse ofruesi i tij mund të dëshmojë se, pavarësisht nga natyra e tij historike, zbulimi i tij do t'i dëmtonte ndërmarrjen në fjalë pasi informacioni ende përbën një element thelbësor të situatës tregtare të ndërmarrjes. Në çdo rast, AK gjithashtu mund të analizojë rast pas rasti nëse informacioni i një periudhe më të fundit ka vlerë të konsiderohet konfidencial apo nëse ai e ka humbur rëndësinë e tij tregtare e për rrjedhim nuk e gëzon këtë status.

38. Të dhëna nga/ ose rreth një ndërmarrje tjetër. Përrjashtimisht, të dhënat e marra si rrjedhim i një kontrate me një ndërmarrje tjetër e cila nënvizohet si konfidenciale mund të trajtohet me akses të kufizuar për palët e tjera. Referencat e përgjithshme për një marrëveshje mos-zbulimi janë të pamjaftueshme për të justifikuar konfidencialitetin e të dhënave të tilla.

39. Informacione statistikore të detajuara ose të agreguara, pavarësisht nga forma e paraqitjes (d.m.th. duke përfshirë grafikët, hartat, tabelat, etj..).

40. Në lidhje me këtë, në procedurat hetimore në përputhje me nenin 4, 5 dhe 9 të ligjit 9121/2003, kualifikimi i një informacioni si konfidencial, nuk është pengesë, për ta bërë atë publik, në qoftë se ky informacion është i domosdoshëm për të provuar një shkelje të dyshuar (dokument fajësues) ose për të shfajësuar një palë (dokument shfajësues).

41. Në këtë rast, nevoja për të garantuar të drejtën e mbrojtjes të palëve përmes sigurimit të një aksesit sa më të gjerë në dosjen e AK mund të kapërcejë nevojën për të mbrojtur informacionin konfidencial të palëve të tjera. AK do të vlerësojë nëse këto rrethana zbatohen për ndonjë situatë specifike. Analiza do të marrë parasysh elementët e mëposhtëm të rëndësishëm:

- Rëndësia e informacionit në përcaktimin nëse një shkelje është kryer apo jo, dhe vlerën e tij të provës;
- Nëse informacioni është i domosdoshëm;
- Shkalla e ndjeshmërisë së përfshirë (deri në çfarë mase zbulimi i informacionit dëmton interesat e personit ose ndërmarrjes në fjalë) dhe;
- Vlerësimi paraprak mbi seriozitetin e shkeljes së pretenduar.

42. Në mënyrë të ngjashme, informacioni i cili lejon të kuptuarit e analizave të bëra nga AK në procedurën e kontrollit të përqendrimeve, nuk mund të deklarohet konfidencial, veçanërisht kur zbulon çështje që mund të paraqesin rrezik për ruajtjen e konkurrencës efektive në tregjet në fjalë ose kur ka angazhime ose klauzola që kufizojnë konkurrencën të cilat nuk mund të vlerësohen si ndihmëse për përqëndrimin në fjalë.

C. Aplikimi për lehtësimin nga gjobat

43. Programi i lehtësimit nga gjobat ofron mbrojtje të informacionit të bërë publik për të përfituar imunitetin. Kështu që, për të siguruar mekanizmat e bashkëpunimit, informacionet që lidhen me një rast lehtësimi nga gjobat, nuk mund të përdoren nga ndonjë autoritet tjetër. Një informacion i tillë mund të shkëmbehet vetëm midis institucioneve / autoriteteve homologe kur aplikanti pranon për të shkëmbyer, ose autoriteti pranues siguron një angazhim me shkrim që të mos përdorë informacionin e transmetuar ose çfarëdo informacioni që mund të marrë pas datës së transmetimit, për të vendosur sanksione mbi aplikantin, filialet ose punonjësit e tij.

44. Për më tepër, AK sa herë që të jetë e mundur, do të bëjë përpjekje për të ruajtur konfidencialitetin e identifikimit të asaj ndërmarrjeje deri në fund të hetimit. Në lidhje me mundësinë për të pasur akses në kërkesën për imunitet të potë ose të pjesshëm të gjobës, nga palë të tjera të interesuara në procedurë, palët kanë të drejtën t'i shikojnë ato, vetëm në atë masë sa është e nevojshme të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes. Asnjë kopje e kërkesës për imunitet, nuk u jepet palëve në asnjë rrethanë.

II.3 Aspektet procedurale në lidhje me kërkesat konfidenciale

45. Informacioni do të klasifikohet si konfidencial kur personi ose ndërmarrja në fjalë ka bërë një kërkesë për këtë qëllim dhe kërkesa është pranuar nga AK.

46. Kërkesat për konfidencialitetin duhet t'i referohen informacionit të konsideruar në seksionin e mëparshëm, d.m.th. vetëm informacionin që kualifikohet si sekret biznesi ose informacion tjetër konfidencial.

47. Në vijim të nenit 17.6 të Rregullores së Procedurave Hetimore, kërkesa për konfidencialitetin, përcakton dokumentet ose pjesët e dokumenteve, të cilat palët konsiderojnë se duhet të konsiderohen konfidenciale. Ajo gjithashtu identifikon ndërmarrjet në lidhje me të cilat këto dokumente do të konsiderohen konfidenciale. Kërkesa e konfidencialitetit, gjithashtu duhet të specifikojë dhe justifikojë arsyet e një kërkesë të tillë.

48. Ashtu si dhe Rregullorja për Procedurat Hetimore edhe neni 17 i Rregullores së Procedurave të Kontrollit të Përqendrimeve, përcakton që palët duhet të identifikojnë qartë çdo material që konsiderohet konfidencial, të japin arsyetimin e duhur dhe të japin një version jo konfidencial, të ndarë nga ai konfidencial, brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK.

49. Justifikimi lidhur me kërkesën për konfidencialitet, si në rocedurat hetimroe ashtu edhe në procedurat e kontrollit të përqëndrimeve, duhet të bëhet individualisht për çdo dokument ose pjesë të dokumentit. Kjo nënkupton se një justifikim i përgjithshëm nuk do të merret në konsideratë nga AK dhe mund të rezultojë në refuzim të kërkesës.

II.4 Vendimi i publikuar nga AK-ja

50. Përveç informacionit konfidencial që është trajtuar nëpërmjet këtij udhëzimi dhe bazuar në nenet 30 të Ligjit 9121/2003 dhe 32 të Rregullores së Funkcionimit, AK mund të hartojë informacione të tjera në versionin publik të vendimeve të saj, siç janë:

- Të dhëna personale (për shembull, informacione që lidhen me një person fizik të identifikuar si person fizik);
- Informacioni i cili, nëse publikohet, mund të rrezikojë programin e lehtësimit të gjobave të AK përfshirë (i) citime nga deklaratat e korporatave të paraqitura nën programin e lehtësimit të gjobave; (ii) informacione të cilat mund të lejojnë identifikimin e personit fizik specifik që ka paraqitur informacione nën programin e lehtësimit të gjobave;
- Informacioni i siguruar nga palët e treta në lidhje me ndërmarrjet që janë në gjendje të ushtrojnë presion shumë të konsiderueshëm ekonomik ose tregtar ndaj konkurrentëve të tyre ose partnerëve të tyre tregtarë, ndaj klientëve ose ndaj furnitorëve; dhe
- Sekretet ushtarake.